



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E MOSZGJEDHSHMËRISË TË KANDIDATIT TË RADHËS NË LISTËN SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU DIBËR, Z. AGRON AHMEDAN QOKU PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT:

Për shpalljen e moszgjedhshmërisë si deputet i Kuvendit, të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Dibër, z. Agron Ahmedan Qoku për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Baza Ligjore:

Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 11 i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreu II, pika 3, e vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.02.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, Qarku Dibër, të subjektit politik Partia Demokratike.



Nr. 143 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e moszgjedhshmërisë si deputet i Kuvendit, të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Dibër, z. Agron Ahmedan Qoku, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.06.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike, për zonën zgjedhore Qarku Dibër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 02 (dy) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Dibër, janë numri rendor 01 (një) znj. Dhurata Bajram Çupi (Tyli) dhe me numër rendor 02 (dy) z. Xhemal Hysen Gjunksi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike Qarku Dibër nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. KQZ me vendimin nr. 566, datë 05.10.2017 vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në Zonën Zgjedhore Qarku Dibër, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, Qarku Dibër, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për Deputet me numër rendor 04 (katër), z. Agron Ahmedan Qoku.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të kreut II, pikës 3, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, me shkresën nr. 1435 prot., datë 13.03.2019, i është drejtuar z. Agron Ahmedan Qoku duke e njoftuar për depozitimin në KQZ të formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit. Posta Shqiptare ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se ky njoftim nuk i është dorëzuar për arsye se adresa e dhënë prej tij në dokumentacionin e kandidimit është e pasaktë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" ka bërë njoftimin e kandidatit, nëpërmjet afishimit publik në këndin e njoftimeve të KQZ-së, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë.

Kjo shpallje është publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Nr. 143 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e moszgjedhshmërisë si deputet i Kuvendit, të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Dibër, z. Agron Ahmedan Qoku, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë

Referuar kreut II, pika 3, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nga data e njoftimit publik, afati i fundit për depozitim në KQZ të formularit të vetëdeklarimit ishte data 08.04.2019.

Brenda afatit të sipërcituar nuk është depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit nga z. Agron Ahmedan Qoku.

Referuar nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 138/2015, refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit përbën shkak për mosregjistrimin apo moszgjedhshmërinë e kandidatit si deputet i Kuvendit. Gjithashtu referuar kreut II, pika 3, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Në këto kushte referuar nenit 11, pika 2 të ligjit nr. 138/2015, duke qenë se kandidati i radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, Qarku Dibër, nuk e paraqiti formularin e vetëdeklarimit, KQZ shpall faktin e moszgjedhshmërisë të z. Agron Ahmedan Qoku si deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe të filloj procedurën për zëvendësimin e mandatit me kandidatin vijues sipas rregullave të përcaktuara në nenin 164, 175 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 11 i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kreu II, pika 3, e vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015",

VENDOSI:

1. Të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, Qarku Dibër, z. Agron Ahmedan Qoku.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 143 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e moszgjedhshmërisë si deputet i Kuvendit, të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, Qarku Dibër, z. Agron Ahmedan Qoku, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë